



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:071055
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05575958

C.nr.468/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtares Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sejdiu, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit M. . B. nga Gj., ., kundër të paditurve E. . B., nga Gj., . dhe “Ar. N.” Sh.p.k, me seli në Gj., të cilin me autorizim e përfaqëson Mejdi Salihu nga Gjilani, , me objekt kontesti, vërtetim i të drejtës së pronësisë në banesë, vlera e kontestit 60,000.00 Euro, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike më datë 15.03.2024, ndërsa me datë 11.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit M. . B. nga G., ndaj të paditurve E. B. nga Gj., Rruga “ F.” dhe “A. N.” Sh. me seli në Gj., me objekt kontesti vërtetim i të drejtës së pronësisë në banesë.

A r s y e t i m

Paditësi M. . B. nga Gj., në këtë gjykatë më datë 15.04.2021, ka paraqitur padinë ndaj të paditurve E. . B., nga Gj., Rr. . dhe “A. N.” Sh., me seli në Gj., me objekt kontesti vërtetim i të drejtës së pronësisë në banesë.

Fillimisht paditësi përfaqësohej nga Mustafë Musa, avokat nga Gjilani, mirëpo i njëjti e kishte njoftuar gjykatën me parashtrësën e datës 11.01.2024 se e denoncon autorizimin për përfaqësim të paditësit me arsyetim se me paditësin nuk ka më kontakte, duke i kërkuar gjykatës që gjykata në vijim të komunikojë me shkresa drejtpërdrejt me palën paditëse.

Gjykata i kishte ftuar palët për seancën e datës 13.02.2024 me fillim nga ora 09:00, ku ftesa për paditësin ishte kthyer e padorëzuar, sipas konstatimit nga fletëkthesa e kthyer gjykatës se paditësi e ka lokalin e mbyllur.

Paditësi ishte ftuar me datë 30.01.2024 përmes emailit, për seancën e datës 13.02.2024 me fillim nga ora 09:00, ndërsa i njëjti kishte komunikuar me gjykatën duke kërkuar nga gjykata që për çdo seancë të ftohet përmes emailit, dhe se dy muajt në vijim nuk është në gjendje të prezentojë në seanca gjyqësore për shkak të gjendjes së tij shëndetësore jo të mirë, ndërsa vërtetimin mjekësor kishte shkruar se do ta dërgojë përmes emailit poashtu. Si rrjedhojë, gjykata këtë seancë e kishte

shtyer për shkak të gjendjes shëndetësore të paditësit. Gjykata nuk ka pranuar asnjë dokument, që vërteton gjendjen jo të mirë shëndetësore të paditësit.

Gjykata, përsëri përmes emailit me datë 13.02.2024 e kishte njoftuar paditësin për seancën e datës 15.03.2024 me fillim nga ora 15:00, duke ia bashkangjitur edhe procesverbalin e seancës së datës 13.02.2024. Në seancën e datës 15.03.2024, gjykata konstatoi se mungon pala paditëse, edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt përmes emailit, ashtu siç kishte kërkuar vetë paditësi, poashtu kanë munguar edhe i padituri i parë dhe përfaqësuesi i të paditurës së dytë. Gjykata konstatoi se paditësi është ftuar përmes emailit, por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar me ndonjë parashtrësë, e as nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.468/2021, më datë 11.04.2024

Gj y q t a r j a
Floriqe Qerimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.